RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

PËR

SISTEMET E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

NË

AGJENCINË SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Tiranë, shtator 2026

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 3
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 3
2. Paraqitja e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 4
3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit 5
II. HYRJA 6
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit 6
2. Identifikimi i çështjes 6
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 6
4. Përgjegjësitë e audituesve 6
5. Kriteret e vlerësimit 7
6. Standardet e auditimit 7
7. Metodat e auditimit 7
8. Dokumentimi i auditimit 7
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT 8
1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim 8
2 Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit 8
2.1 Auditimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit 8
2.2 Auditimi i Sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave 12
IV. REKOMANDIME 17

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", zhvilloi auditimin mbi Teknologjinë e Informacionit në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, nga data 10.06.2026 deri në 08.07.2026.
Grupi i auditimit pasi mblodhi informacione të mjaftueshme, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimet e auditimit. Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

a. *Përshkrim i shkurtër për subjektin në auditim*

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ushtron funksionet e saj në bazë të Ligjit nr. 18/2017 "*Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*" dhe akteve ligjore e nënligjore në zbatim të tij. Agjencia është person juridik, në varësi të ministrit që bashkërendon çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, aktualisht institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Ajo financohet nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe burime të tjera sipas ligjit, organizohet në nivel qendror dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Sipas Rregullores së Brendshme të ASHDMF, Agjencia është institucioni përgjegjës për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës. Ky rol përfshin zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi, dhuna, shfrytëzimi dhe forma të tjera të cenimit të të drejtave të tij. Misioni i Agjencisë është promovimi, monitorimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës, si dhe ngritja e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit.
Në përmbushje të këtij misioni, ASHDMF ka detyrimin të koordinojë aktorët institucionalë në nivel qendror dhe vendor, të mbështesë strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës, të monitorojë zbatimin e legjislacionit dhe dokumenteve strategjike, të kontrollojë cilësinë e shërbimeve të strukturave vendore, të përgatisë raporte periodike dhe vjetore, si dhe të kontribuojë në hartimin e politikave, udhëzimeve metodologjike dhe standardeve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Rregullorja e Brendshme parashikon gjithashtu detyra konkrete për sektorët përgjegjës, përfshirë koordinimin e aktorëve, mbështetjen teknike për strukturat vendore, monitorimin e rasteve, përgatitjen e raporteve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.
Në lidhje me sistemin e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, dokumentacioni evidenton se NJMF-të dhe PMF-të janë strukturat përgjegjëse për parandalimin, identifikimin, vlerësimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik. Roli i ASHDMF në këtë proces është kryesisht koordinues, monitorues, metodologjik dhe mbështetës. Në përgjigjen ndaj pyetësorit të KLSH-së, ASHDMF ka sqaruar se menaxhimi konkret i rasteve nuk është kompetencë e saj, por e Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki ose njësi administrative, dhe se për këtë arsye Agjencia nuk ka sisteme të menaxhimit të rasteve.

b. *Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij*

Rëndësia e këtij auditimi qëndron në faktin se Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është institucioni qendror përgjegjës për garantimin, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të të drejtave të fëmijës në Republikën e Shqipërisë. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Agjencia administron të dhëna të një kategorie veçanërisht të ndjeshme. Roli i saj institucional në mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës, në koordinimin ndërmjet strukturave shtetërore dhe në ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, e bën një institucion me ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien dhe sigurinë e një grupi vulnerabël të shoqërisë.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i auditimit bazuar në programin e auditimit është vlerësimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të, për periudhën 01.01.2025-31.12.2025.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave

Grupi i auditimit, në fazën e planifikimit, mblodhi informacion të përgjithshëm mbi subjektin nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave për identifikimin e zonave me risk të lartë, mbi bazën e të cilave u hartuan drejtimet e auditimit dhe kërkesat për informacion, në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Metodat dhe teknikat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave janë përdorur veçmas ose të kombinuara, duke përfshirë: shqyrtimin e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe të dokumenteve mbi përdorimin e sistemeve informatike; intervistat me personat përgjegjës; verifikimin teknik dhe analizimin e funksioneve të sistemit e të dhënave të eksportuara nga sistemet; si dhe rakordimin e informacionit të marrë nga subjekti me të dhënat publike të faqes zyrtare dhe evidencat teknike. Të dhënat e grumbulluara u vlerësuan përballë kritereve ligjore, rregullative dhe standardeve ndërkombëtare (ISSAI 5300, ISSAI 5310, ISO/IEC 27001), me qëllim formimin e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve mbi bazën e një evidence të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme audituese.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga auditimi rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 9 gjetje dhe ka dhënë 9 rekomandime.

2. Paraqitja e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

- Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës nuk ka në strukturën e saj një punonjës të dedikuar për kryerjen e detyrave që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Gjithashtu, institucioni nuk disponon asnjë akt administrativ si, urdhër, vendim apo shkresë, nëpërmjet të cilit të jetë caktuar struktura apo specialisti përgjegjës për ushtrimin e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të cilat në përputhje me nenin 25 pika "b" të Ligjit nr. 43/2023 "*Për qeverisjen elektronike*", i ndryshuar ku përcaktohet se AKSHI është ofruesi i shërbimeve të përqendruara TIK.
- Nga auditimi i pajisjeve informatike rezultoi se nga 9 kompjuterët në funksion të punonjësve të strukturës, me sisteme operimi si në vijim;
- 3 kompjuterë përdorin Windows 11, version aktual, i mbështetur nga prodhuesi;
- 3 kompjuterë përdorin Windows 10, për të cilin mbështetja standarde nga Microsoft ka përfunduar më 14 tetor 2025;
- 3 kompjuterë përdorin Windows 7, për të cilin përditësimet e sigurisë kanë përfunduar prej kohësh.

Bazuar në sa më sipër, 6 nga 9 pajisjet, operojnë me sisteme që nuk përfitojnë përditësime sigurie nga prodhuesi. Kjo situatë është në kundërshtim me nenin 22 të Ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i cili parashikon se kontrolluesi zbaton masa të duhura teknike dhe organizative dhe duhet të jetë në gjendje të provojë zbatimin e tyre, si dhe me nenin 5 të Rregullores së ASHDMF-së "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", i cili kërkon garantimin e integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave personale, kërkesë që nuk mund të konsiderohet e përmbushur kur infrastruktura teknike përfshin sisteme operimi që nuk përfitojnë më përditësime sigurie nga prodhuesi.

- Nga auditimi u konstatua se Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në cilësinë e kontrolluesit, ushtron koordinim funksional mbi punonjësit socialë të njësive për mbrojtjen e fëmijës pranë bashkive, të cilët aksesojnë dhe përpunojnë të dhëna personale të kategorive të veçanta të rasteve të mbrojtjes së fëmijës. Deklarata e konfidencialitetit që nënshkruhet prej tyre është formulari i parashikuar si Aneksi 11 i VKM nr. 578, datë 3.10.2018, ndërsa ndarja e informacionit realizohet nëpërmjet formularit "Miratimi për ndarjen e informacionit" të së njëjtës VKM. Njëkohësisht, ASHDMF nuk ka hartuar një instrument të vetin, në formën e një deklarate të veçantë konfidencialiteti të nënshkruar drejtpërdrejt nga punonjësit socialë që përpunojnë të dhëna nën autoritetin e saj. Mungesa e saj krijon dobësi në garantimin e përgjegjshmërisë së punonjësve socialë për ruajtjen e konfidencialitetit, duke rritur rrezikun e cenimit të sigurisë dhe privatësisë së të dhënave personale të fëmijëve.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrin masa për të kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit caktimin me akt administrativ, të një strukture ose specialisti përgjegjës për ushtrimin, administrimin dhe koordinimin e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, të hartojë dhe zbatojë një plan konkret veprimi, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare te Shoqërisë së Informacionit si institucion përgjegjës për infrastrukturën qendrore të teknologjisë së informacionit, për heqjen nga përdorimi ose përditësimin e menjëhershëm të 6 pajisjeve me sisteme operimi që nuk mbështeten më nga prodhuesi. Njëkohësisht, të mbahet një inventar i përditësuar i pajisjeve informatike me evidentimin e versioneve të sistemeve të operimit dhe të datave të përfundimit të mbështetjes.
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, brenda kompetencave të saj, të hartojë dhe miratojë me urdhër të titullarit një deklaratë të veçantë konfidencialiteti, e cila të nënshkruhet drejtpërdrejt nga punonjësit socialë të njësive për mbrojtjen e fëmijës që përpunojnë të dhëna nën autoritetin e saj, si dhe të hartojë udhëzime të shkruara për përpunimin e këtyre të dhënave.

3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310, si dhe në nenet 3 dhe 14 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*", bazuar në gjetjet e auditimit, vlerësojmë se në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës nevojitet ndërmarrja e masave organizative, teknike dhe procedurale për të forcuar kontrollin e brendshëm, për të rritur nivelin e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale dhe për të garantuar përputhshmërinë e plotë me kuadrin ligjor në fuqi. Institucioni ka ndërmarrë hapa pozitivë në zbatim të Ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", konkretisht caktimin e Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe miratimin e rregullores përkatëse, por këto akte kanë mbetur kryesisht në nivel formal, pasi regjistri i veprimtarive të përpunimit nuk ka filluar të plotësohet dhe një pjesë e masave teknike të parashikuara në rregullore janë kompetencë e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Mungesa e një strukture ose specialisti të caktuar me akt administrativ për funksionet e teknologjisë së informacionit, përdorimi i sistemeve të operimit jashtë mbështetjes së sigurisë nga prodhuesi, mungesa e trajnimeve profesionale, si dhe përdorimi i instrumenteve juridike me bazë ligjore të shfuqizuar, rrisin ekspozimin ndaj rreziqeve të sigurisë dhe ulin efektivitetin e kontrolleve të brendshme. Këto mangësi marrin peshë të shtuar duke pasur parasysh se institucioni administron të dhëna të kategorive të veçanta që lidhen me fëmijë në nevojë për mbrojtje.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", në zbatim të programit nr. 622/1 prot., datë 10.06.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 10.06.2026 deri më datë 08.07.2026, në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, u krye auditimi mbi teknologjinë e informacionit, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. C., përgjegjës grupi;
2. A. K., auditues;
3. M. B., auditues.

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, nga data 10.06.2026 deri më datë 08.07.2026. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Objekti i Auditimit është përcaktimi nëse sistemet e teknologjisë së informacionit në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, mbrojnë informacionin; ruajnë integritetin e të dhënave; sigurojnë disponueshmërinë dhe mbështeten në kontrolle të duhura.

Qëllimi i Auditimit TIK është vlerësimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

2. Identifikimi i çështjes

Ky auditim ka si objekt vlerësimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025.

Si drejtime të auditimit në programin me nr. 622/1 prot., datë 10.06.2026, janë identifikuar drejtimet në vijim:

1. Auditimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.
2. Auditimi i Sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ushtron funksionet e saj në bazë të Ligjit nr. 18/2017 "*Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*" dhe akteve ligjore e nënligjore në zbatim të tij. Agjencia është person juridik, në varësi të ministrit që bashkërendon çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, aktualisht institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Ajo financohet nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe burime të tjera sipas ligjit, organizohet në nivel qendror dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2025 deri në 31.12.2025, në drejtim të teknologjisë së informacionit, që është në përdorim dhe i shërben institucionit.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 622/1 prot., datë 10.06.2026 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit të teknologjisë së informacionit si dhe legjislacionin e fushës në të cilën operon ASHDMF. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar marrjen e masave, për përmirësimin e situatës.

Kriteret ligjore, rregullative dhe standardet mbi të cilat është mbështetur auditimi, janë si më poshtë:

- Ligji nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- Ligji nr. 18/2017 "*Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës*";
- Ligji nr. 124, datë 19.12.2024, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*";
- Ligji nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar;
- Ligji nr. 43/2023 "*Për qeverisjen elektronike"*, ndryshuar me Ligjin nr. 100, datë 12.9.2024 dhe nr. 25/2026, datë 20.2.2026.
- Ligji nr. 25/2024 "*Për Sigurinë Kibernetike*";
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali i Auditimit IT si dhe Standardet Ndërkombëtare ISO27001, etj.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, ISO 27001, etj.

7. Metodat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit dhe akteve të brendshme si: rregullore, politika, procedura, marrëveshje bashkëpunimi dhe kontrata të TI-së;
- Intervistat me personelin kyç të subjektit dhe me strukturat përgjegjëse;
- Verifikimi i konfigurimeve dhe i masave teknike e organizative të sigurisë;
- Teknika me ndihmën e kompjuterit për ekzaminimin e faqes zyrtare të internetit.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara nga skanime;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ushtron funksionet e saj në bazë të Ligjit nr. 18/2017 "*Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*" dhe akteve ligjore e nënligjore në zbatim të tij. Agjencia është person juridik, në varësi të ministrit që bashkërendon çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, aktualisht institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Ajo financohet nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe burime të tjera sipas ligjit, organizohet në nivel qendror dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Sipas Rregullores së Brendshme të ASHDMF, agjencia është institucioni përgjegjës për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës. Ky rol përfshin zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi, dhuna, shfrytëzimi dhe forma të tjera të cenimit të të drejtave të tij. Misioni i Agjencisë është promovimi, monitorimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës, si dhe ngritja e një sistemi të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit.
Në përmbushje të këtij misioni, ASHDMF ka detyrimin të koordinojë aktorët institucionalë në nivel qendror dhe vendor, të mbështesë strukturat vendore të mbrojtjes së fëmijës, të monitorojë zbatimin e legjislacionit dhe dokumenteve strategjike, të kontrollojë cilësinë e shërbimeve të strukturave vendore, të përgatisë raporte periodike dhe vjetore, si dhe të kontribuojë në hartimin e politikave, udhëzimeve metodologjike dhe standardeve në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Rregullorja e Brendshme parashikon gjithashtu detyra konkrete për sektorët përgjegjës, përfshirë koordinimin e aktorëve, mbështetjen teknike për strukturat vendore, monitorimin e rasteve, përgatitjen e raporteve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.
Në lidhje me sistemin e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, dokumentacioni evidenton se NJMF-të dhe PMF-të janë strukturat përgjegjëse për parandalimin, identifikimin, vlerësimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik. Roli i ASHDMF në këtë proces është kryesisht koordinues, monitorues, metodologjik dhe mbështetës. Në përgjigjen ndaj pyetësorit të KLSH-së, ASHDMF ka sqaruar se menaxhimi konkret i rasteve nuk është kompetencë e saj, por e Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki ose njësi administrative, dhe se për këtë arsye Agjencia nuk ka sisteme të menaxhimit të rasteve.

2 Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit


2.1 Auditimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

Në zbatim të pikës 1, të Programit të Auditimit nr. 622/1, datë 10.06.2026, u shqyrtua, si më poshtë:
- Akte ligjore / nënligjore, rregullore mbi të cilat institucioni kryen aktivitetin e tij;
- Organigrama dhe struktura organizative e institucionit;
- Rregullore e Brendshme protokolluar me nr. 24/2 prot., datë 20.02.2026 *"Për miratimin e rregullores së brendshme të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"*;
- Rregullore *"Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale"* miratuar me Urdhër nr. 13 prot., datë 04.05.2026, protokolluar me nr. 99 prot., datë 04.05.2026.
- Faqja web e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- Pyetësorë dhe intervista zhvilluar me personat përgjegjës, etj.

Vlerësimi i Burimeve Njerëzore

Për kryerjen e funksioneve institucionale Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka një strukturë organizative të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 23, datë 13.02.2025 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"*, protokolluar në ASHDMF me nr. 39 prot., datë 17.02.2025 e cila është e ndërtuar mbi bazën e tre Sektorëve në varësi direkte me Drejtorin e Përgjithshëm.

Diagrama nr.1: Organigrama e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës



Burimi: ASHDMF, përpunuar nga grupi i auditimit

Numri i përgjithshëm i punonjësve në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës është gjithsej 9 (nëntë).

Tabela nr.1: Struktura e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

Nr.	Pozicioni	Nr. i punonjësve
Drejtori		1
Sektori i Programeve për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës nga Dhuna, Abuzimi, Shfrytëzimi		3
1	Përgjegjës Sektori	1
2	Specialist	2
Sektori i Monitorimit dhe Kontrollit		3
1	Përgjegjës Sektori	1
2	Specialist	2
Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse		2
1	Specialist	2
Totali		9

Burimi: ASHDMF, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës nuk ka në strukturën e saj një punonjës të dedikuar për kryerjen e detyrave që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Gjithashtu, institucioni nuk ka asnjë urdhër, vendim apo shkresë, nëpërmjet të cilit të jetë caktuar struktura apo specialisti përgjegjës për ushtrimin e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Me Urdhrin e titullarit nr. 97 datë 07.07.2025, protokolluar në ASHDMF me nr. 97 prot., datë 07.07.2025 është caktuar nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe janë përcaktuar detyrat që ai duhet të kryejë.

Detyrat dhe përshkrimet e punës së punonjësve janë pjesë përbërëse e Rregullores së Brendshme protokolluar në ASHDMF me nr. 24/2 prot., datë 20.02.2026 *"Për miratimin e rregullores së brendshme të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës".*

Nga auditimi u konstatua se, në rregulloren e brendshme të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës saktësohet në nenin 11 pika 2 "j" se, Specialisti i Sektorit të Monitorimit dhe Kontrollit (Jurist) kryen ndër të tjera edhe funksionet e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale caktuar me urdhër të titullarit të institucionit.

Trajnimet

Zhvillimi i vazhdueshëm i trajnimeve është një element thelbësor për rritjen e njohurive në burimet njerëzore të institucionit, veçanërisht në drejtim të mbrojtjes së të dhënave personale. Në këtë kuadër, është e nevojshme që institucioni të identifikojë periodikisht nevojat specifike të stafit për trajnime në këtë fushë.
Sipas Ligjit nr. 124/2024 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale",* ndër detyrat e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale (DPO) parashikohet shprehimisht kryerja e trajnimeve të stafit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave.

Nga Nëpunësi për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është dërguar kërkesë me email në datën 07.07.2025 për zhvillimin e trajnimeve pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim rritjen e kapaciteteve të tij profesionale në këtë fushë, duke mundësuar më pas dhe zhvillimin e trajnimeve për stafin e institucionit. Për këtë nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë konkrete për zhvillimin e këtyre trajnimeve.

Mungesa e trajnimeve mbi mbrojtjen e të dhënave personale rrit rrezikun që punonjësit të mos zbatojnë si duhet detyrimet e parashikuara në ligj, duke cënuar potencialisht sigurinë dhe integritetin e të dhënave të përpunuara nga institucioni. Për më tepër, mungesa e kualifikimit të vetë nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave përbën pengesë për trajnimin e mëtejshëm të stafit, duke ndikuar drejtpërdrejt edhe në cilësinë e masave për mbrojtjen e të dhënave të fëmijëve, që përbën fushën kryesore të veprimtarisë së institucionit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe nga komunikimet verbale me përfaqësues të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, u konstatua se punonjësit e institucionit nuk kanë ndjekur trajnime për kualifikim profesional gjatë periudhës objekt auditimi.

Auditimi i faqes zyrtare të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
Ligji nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar, përcakton detyrimin e institucioneve publike për publikimin e informacionit të plotë, të saktë dhe të përditësuar për publikun.
Në zbatim të këtij ligji, institucioni ka publikuar informacione të nevojshme në programin e transparencës.
Në përmbushje të kërkesave të Ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", është miratuar me urdhrin e titullarit të ASHDMF nr. 97, datë 07.07.2025 nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale. Rregullorja e mbrojtjes së të dhënave përcakton se nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të ushtrojë funksionin në mënyrë të pavarur, të shërbejë si pikë kontakti me Komisionerin, të këshillojë stafin, të monitorojë përputhshmërinë, të asistojë në menaxhimin e incidenteve dhe të mbikëqyrë regjistrin e veprimtarive të përpunimit. Megjithëse ASHDMF ka emëruar Nëpunësin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, në faqen zyrtare femijet.gov.al dhe faqen e kontaktit nuk është publikuar asnjë informacion identifikues mbi NMDP-n si emri, emaili, apo funksioni. Neni 34/3 i Ligjit 124/2024 kërkon shprehimisht publikimin e të dhënave të kontaktit të NMDP-s si detyrim i pavarur nga emaili institucional i përgjithshëm.


Nga auditimi i strukturës së menu-së së faqes zyrtare të ASHDMF-së, u konstatuan këto mangësi:

- Moduli "*Marrëveshje*" është publikuar dy herë, përkatësisht te seksioni "*Legjislacioni*" dhe te seksioni "*Bashkëpunim*", duke krijuar dublikim të padobishëm të informacionit dhe duke vështirësuar lundrimin e përdoruesit;

- Seksioni "*Statistika për fëmijët*", që duhet të ofrojë të dhëna statistikore mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, nuk është i aksesueshëm, duke privuar publikun nga informacion që duhet të jetë i disponueshëm sipas detyrimeve të transparencës;
- Te moduli i Transparencës, opsioni "*Programi i Transparencës*" është publikuar dy herë, gjë që ndikon negativisht në qartësinë dhe strukturën e menu-së;
- Disa linqe të cilat shfaqin mesazhin '404: Page Not Found', duke pamundësuar aksesimin e informacionit përkatës;
- Konstatohet se ka linqe që të drejtojnë në video që nuk janë më të disponueshme, pasi shfaqet mesazhi "Video ID … has been deleted!", duke pamundësuar aksesimin e përmbajtjes;
- Gjatë verifikimit u konstatua se një nga linqet e publikuara në faqen zyrtare të ASHDMF-së ridrejton në faqen e Këshillit të Evropës (Council of Europe) ku dokumenti nuk është publik, dhe për të cilin kërkohet autentifikim, duke pamundësuar aksesimin e informacionit nga publiku;
- Një pjesë e dokumenteve të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, përfshirë te programi i transparencës, por jo vetëm, shkarkohen automatikisht në pajisjen e përdoruesit, pa kërkuar konfirmim paraprak, çka përbën praktikë jo standarde dhe potencialisht problematike nga pikëpamja e sigurisë së informacionit;

U konstatua se në faqen zyrtare të ASHDMF-së mungon informacioni mbi datën e publikimit dhe datën e përditësimit të fundit të përmbajtjes, duke kufizuar transparencën dhe mundësinë e verifikimit, në kundërshtim me Vendimin nr. 782, datë 18.12.2024 *"Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të Autoriteteve Publike"*.

Figura nr. 1: Faqja zyrtare e internetit të ASHDMF-së



Burimi: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur komente mbi rekomandimet e përcjella me Projektaportin me shkresën nr. 622/2 Prot, datë 28.07.2026.

2.2 Auditimi i Sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave

Në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit nr. 622/1, datë 10.06.2026, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Ligji nr. 18/2017 "*Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*";
- Ligji nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*";
- Ligji nr. 2/2017 "*Për Sigurinë Kibernetike*", shfuqizuar nga Ligji nr. 25/2024 "*Për Sigurinë Kibernetike*", hyrë në fuqi më 03.05.2024;
- Akte nënligjore mbi të cilat institucioni kryen aktivitetin e tij;
- Rregullore e Brendshme protokolluar me nr. 24/2 prot., datë 20.02.2026 *"Për miratimin e rregullores së brendshme të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"*;
- Rregullore *"Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale"* miratuar me Urdhër nr. 13 prot., datë 04.05.2026, protokolluar me nr. 99 prot., datë 04.05.2026.
- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet ASHDMF-së dhe AKCESK-së me nr.86 prot., datë 06.02.2024.
- Pyetësorë dhe intervista zhvilluar me personat përgjegjës, etj.

Gjatë procesit të auditimit, përfaqësues të ASHDMF-së deklaruan se institucioni nuk disponon sisteme informatike të dedikuara për menaxhimin e veprimtarisë, përfshirë sisteme të menaxhimit të rasteve. Komunikimi me institucionet publike në nivel qendror dhe vendor, si dhe me subjektet e tjera, realizohet kryesisht nëpërmjet shkresave zyrtare dhe postës elektronike zyrtare.

Administrimi i informacionit dhe mbrojtja e të dhënave personale

Për shkak të natyrës së veprimtarisë së ASHDMF, agjencia administron dhe përpunon informacion me ndjeshmëri të lartë, përfshirë të dhëna që lidhen me fëmijë, familje, raste në nevojë për mbrojtje, raporte, ankesa, komunikime ndërinstitucionale dhe të dhëna të tjera që mund të identifikojnë individë. Për këtë agjencia ka hartuar, miratuar dhe publikuar në faqen zyrtare të internetit rregulloren *"Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale"* miratuar me urdhrin e titullarit nr. 13 prot., datë 04.05.2026, protokolluar me nr. 99 prot., datë 04.05.2026.

Në këtë rregullore, ASHDMF në cilësinë e kontrolluesit, është përgjegjëse për përputhshmërinë me Ligjin nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" dhe për zbatimin e masave organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë, konfidencialitetit dhe integritetit të të dhënave personale, në çdo fazë të përpunimit.

E njëjta rregullore përcakton se përpunimi duhet të kryhet në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës, minimizimit, saktësisë, kufizimit të afatit të ruajtjes, sigurisë, llogaridhënies, integritetit dhe konfidencialitetit. Në këtë dokument cilësohet gjithashtu që çdo proces përpunimi duhet të pasqyrohet në regjistrin e veprimtarive të përpunimit, të dhënat të ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme, dhe pas përfundimit të afatit të fshihen, anonimizohen ose arkivohen sipas rregullave përkatëse.

Për kategoritë e veçanta të të dhënave personale, rregullorja parashikon që përpunimi të kryhet vetëm kur plotësohen kushtet ligjore, në veçanti për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e mbrojtjes së fëmijës.
Përpunimi duhet të kryhet vetëm nga punonjës të pajisur me deklaratë konfidencialiteti, duke përdorur forma ose sisteme të miratuara nga ASHDMF, me akses të kufizuar sipas rolit dhe me regjistrim të veprimeve. Shkëmbimi i të dhënave lejohet vetëm për qëllime shërbimi, mbi bazë ligjore, nëpërmjet kanaleve zyrtare të sigurta dhe duke dokumentuar marrësit.

Të gjithë punonjësit në strukturën e ASHDMF-së kanë nënshkruar deklaratë konfidencialiteti, e cila përmban dispozitë shprehëse mbi vazhdimësinë e detyrimit, sipas së cilës *"dispozitat përkatëse zbatohen edhe pasi marrëdhënia e punës me ASHDMF ka përfunduar"*.

Nga auditimi u konstatua se deklaratat e konfidencialitetit të nënshkruara nga punonjësit e ASHDMF-së nuk janë rinovuar në përputhje me Aneksin 1 të Rregullores "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", miratuar me urdhrin nr. 13, datë 04.05.2026. Ndryshimi thelbësor i deklaratës së miratuar në Aneksin 1 me deklaratat e nënshkruara faktikisht nga punonjësit, qëndron në bazën ligjore të cituar, ku deklaratat ekzistuese të nënshkruara bazohen në Ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i cili është shfuqizuar, ndërkohë që Aneksi 1 i rregullores aktuale përcakton si bazë ligjore Ligjin nr.124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*". Gjithashtu, deklarata e konfidencialitetit e publikuar në faqen zyrtare citon Ligjin nr.9887/ 2008, i cili u shfuqizua me hyrjen në fuqi të Ligjit 124/2024. Referenca ndaj një ligji të shfuqizuar nuk mund të konsiderohet bazë e vlefshme ligjore për detyrimet e konfidencialitetit të punonjësve sipas Nenit 30 të Ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*".

ASHDMF-ja, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave, gjatë verifikimeve në terren pranë njësive për mbrojtjen e fëmijës në bashki, kontrollon ndër të tjera edhe deklaratën e konfidencialitetit të nënshkruar nga punonjësit socialë të bashkisë, të cilët aksesojnë dhe përpunojnë të dhëna personale/të ndjeshme të rasteve të mbrojtjes së fëmijës nën koordinimin funksional të ASHDMF-së.
Megjithatë, deklarata e konfidencialitetit që nënshkruhet nga punonjësit socialë është formulari i parashikuar si Aneksi 11 në VKM nr. 578, datë 3.10.2018 i cili nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 124/2024.

Nga auditimi rezultoi se formulari "*Miratimi për ndarjen e informacionit*", i parashikuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018 "*Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes*", përdoret nga punonjësit socialë të njësive për mbrojtjen e fëmijës pranë bashkive, por nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", për arsye se:

- formulari e trajton ndarjen e informacionit të fëmijës si çështje pëlqimi (consent), duke krijuar kështu bazën e gabuar ligjore për përpunimin e të dhënave. Në të vërtetë, përpunimi i të dhënave personale/ndjeshme të fëmijëve në kuadër të mbrojtjes dhe ruajtjes së interesit më të lartë të tyre nga autoritetet publike nuk bazohet në pëlqim, por në detyrën ligjore dhe interesin publik, sipas Nenit 7, pika 1, shkronjat "c" dhe "d", si dhe Nenit 9, pika 2, shkronja "e" të Ligjit nr.124/2024. Kjo mospërputhje krijon rrezikun praktik që institucioni të mos ndajë informacionin e domosdoshëm për mbrojtjen e fëmijës në rastet kur prindi ose kujdestari refuzon nënshkrimin e formularit, duke cenuar kështu vetë qëllimin e VKM-së.
- formulari përmban pjesërisht informacionin e detyrueshëm sipas Nenit 13 të Ligjit nr. 124/2024, konkretisht: identitetin por jo të dhënat e kontaktit të kontrolluesit dhe të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave personale, bazën ligjore specifike të përpunimit, afatin e ruajtjes së të dhënave, marrësit konkretë të informacionit, formulari referon në mënyrë të përgjithshme "autoritete e organizata të tjera" pa i identifikuar ato, si dhe të drejtat e subjektit të të dhënave, përfshirë të drejtën e ankesës pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- formulari nuk bën dallimin e kërkuar në Nenin 8, pika 6 e Ligjit nr.124/2024 midis fëmijëve mbi 16 vjeç, të cilët mund të japin vetë pëlqimin, dhe fëmijëve nën këtë moshë, për të cilët pëlqimi duhet të jepet ose autorizohet nga prindi ose kujdestari ligjor.

- formulari nuk parashikon procedurën e përpunimit të të dhënave pa pëlqim në situatat urgjente, kur mbrojtja e interesave jetikë të fëmijës nuk lejon vonesë, në kundërshtim me Nenin 9, pika 2, shkronja "c" të Ligjit nr. 124/2024.

Për sa më sipër, formulari "*Miratimi për ndarjen e informacionit*", i parashikuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018, i konsideruar si instrument ligjor për të siguruar konfidencialitetin e punonjësve socialë të bashkive, nuk plotëson kërkesat ligjore në fuqi, konkretisht Nenin 30/2 të Ligjit nr. 124/2024, i cili parashikon shprehimisht se çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit dhe ka akses në të dhënat personale, i përpunon ato vetëm sipas udhëzimeve të kontrolluesit, duke përfshirë detyrimin e konfidencialitetit. Për më tepër, ASHDMF nuk ka siguruar një mjet juridik të hartuar prej saj, në formën e një deklarate të veçantë konfidencialiteti të nënshkruar drejtpërdrejt nga punonjësit socialë si përpunues të informacionit sipas kërkesave të Ligjit nr. 124/2024, që të garantojë në mënyrë të plotë dhe të vlefshme ligjërisht detyrimin e konfidencialitetit për punonjës jashtë strukturë së ASHDMF-së që janë punonjësit socialë të njësisë së mbrojtjes së fëmijës në bashki.

Siguria e informacionit

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, versionet e Sistemit Operative për 9 kompjuterë të vendosur në funksion, rezultuan të jenë 3 kompjuterë me sistem operimi Windows 11, 3 kompjuterë me sistem operimi Windows 10, 3 kompjuterë me sistem operimi Windows 7.

Nga auditimi i pajisjeve informatike të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, u konstatua se, nga 9 kompjuterët e vendosur në funksion të punonjësve të strukturës, sistemet e operimit ndahen si më poshtë:

- 3 kompjuterë me sistem operimi Windows 11 — version aktual, i mbështetur nga prodhuesi.
- 3 kompjuterë me sistem operimi Windows 10, për të cilin mbështetja standarde nga Microsoft ka përfunduar më 14 tetor 2025. Pas kësaj date, prodhuesi nuk ofron më përditësime sigurie, apo përmirësime teknike për këtë version.
- 3 kompjuterë me sistem operimi Windows 7, version për të cilin përditësimet e sigurisë kanë përfunduar prej kohe dhe nuk ofrohen më nga prodhuesi.

Në rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave Personale, në zbatim të ligjit nr. 124/2024, kërkohet garantimi i integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave personale të përpunuara nga institucioni, neni 5, kërkesë që nuk mund të plotësohet plotësisht kur infrastruktura teknike ku bëjnë pjesë dhe sistemet e operimit që nuk përfitojnë më përditësime sigurie nga prodhuesi.

Në përmbushje të kërkesave të Ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", është caktuar nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale miratuar me urdhrin e titullarit të ASHDMF nr. 97, datë 07.07.2025. Po në zbatim të të njëjtit ligj është hartuar dhe politikat e privatësisë të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të internetit dhe përditësuar për herë të fundit në datën 26.02.2026.

Nga auditimi mbi këtë politikë të hartuar dhe të publikuar në faqe u konstatua se neni 34/3 kërkon shprehimisht që kontrolluesi që është ASHDMF të publikojë të dhënat e kontaktit të nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave. Si pikë kontakti në faqen zyrtare është publikuar vetëm adresa e përgjithshme institucionale info@femijet.gov.al, pa asnjë të dhënë identifikuese apo kontakti të dedikuar të Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nga auditimi mbi rregulloren *"Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale"* miratuar me urdhrin nr. 13 prot., datë 04.05.2026, protokolluar me nr. 99 prot., datë 04.05.2026, u konstatua se megjithëse është përcaktuar në aneksin 6 formati i regjistrit të veprimtarive të përpunimit që nevojitet të plotësohet nga çdo drejtori/sektor, nuk ka filluar plotësimi i të dhënave lidhur me përpunimin.

Nga auditimi u konstatua se Rregullorja e ASHDMF-së "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", miratuar me Urdhër të Drejtorit nr. 13, protokolluar me nr. 99 prot., datë 04.05.2026, parashikon një sërë detyrash dhe masash teknike të sigurisë që i ngarkohen ASHDMF-së si kontrollues i të dhënave, të cilat në realitet janë kompetencë dhe përgjegjësi ekskluzive e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), sipas Ligjit nr. 43/2023 "*Për qeverisjen elektronike*". Konkretisht, rregullorja parashikon se ASHDMF-ja zbaton vetë masa si: administrimin e aksesit të bazuar në rol dhe kredenciale individuale, garantimin e kanaleve të sigurta për dërgimin dhe marrjen e të dhënave, mbrojtjen e pajisjeve zyrtare me fjalëkalim dhe politika aksesi, ndalimin e nxjerrjes së të dhënave në pajisje të jashtme, si dhe bllokimin e menjëhershëm të aksesit të punonjësve të larguar nga detyra.

Këto detyrime, nuk mund të zbatohen nga ASHDMF në mënyrë të pavarur, për dy arsye:
- së pari, ASHDMF nuk disponon sisteme informatike të dedikuara dhe menaxhimi i informacionit realizohet kryesisht nëpërmjet shkresave zyrtare dhe postës elektronike zyrtare.
- së dyti, sipas Ligjit nr. 43/2023, administrimi i infrastrukturës qendrore TIK, i postës elektronike shtetërore, i sistemeve të autentifikimit dhe kredencialeve, i Qendrës së të Dhënave Qeveritare, i sistemeve të vazhdueshmërisë së punës dhe rikuperimit nga fatkeqësia, si dhe përcaktimi i standardeve të sigurisë TIK për institucionet publike, janë kompetencë ekskluzive e AKSHI-t, sipas neneve 9, 24, 25, 26, 27, 41 dhe 42 të këtij ligji. Prandaj, ASHDMF nuk mund të veprojë si institucion i pavarur në infrastrukturën teknike, por si përdorues i shërbimeve dhe infrastrukturave të ofruara nga AKSHI.

Kjo situatë tregon se rregullorja e brendshme e ASHDMF-së nuk pasqyron ndarjen e saktë dhe ligjore të përgjegjësive midis institucionit si kontrollues i të dhënave dhe AKSHI-t si administrator i infrastrukturës qendrore TIK, duke krijuar kështu një mospërputhje ndërmjet detyrimeve të parashikuara në rregullore dhe mundësive reale të zbatimit të tyre. Mospërputhja e identifikuar është në kundërshtim me kërkesat e Nenit 22 të Ligjit nr. 124/2024, i cili parashikon se kontrolluesi zbaton masa të duhura teknike dhe organizative dhe duhet të jetë në gjendje të provojë zbatimin e tyre, si dhe me ndarjen institucionale të kompetencave të përcaktuara nga Ligji nr. 43/2023 "*Për qeverisjen elektronike*".

ASHDMF, me qëllim forcimin e bashkëpunimit institucional dhe përcaktimin e mënyrave të bashkërendimit të punës brenda kompetencave ligjore të secilit institucion, ka lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi me Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike - AKCESK, me nr. 86 prot., datë 06.02.2024. Marrëveshja synon bashkërendimin e veprimtarisë ndërinstitucionale në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve në hapësirën kibernetike, duke reflektuar detyrimin ligjor të dy institucioneve për garantimin e sigurisë së fëmijëve nga kërcënimet, shantazhet dhe sulmet kibernetike.

Nga auditimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit protokolluar në Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës me nr. 16/2 prot., dhe në Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike me nr. 86 prot., datë 06.02.2024, lidhur ndërmjet dy institucioneve, u konstatua se baza ligjore referuar nenit 3 të marrëveshjes përmban akte ligjore e nënligjore të cilat janë shfuqizuar ose zëvendësuar pas nënshkrimit të saj, si dhe se njëra nga palët nënshkruese AKCESK, ka pësuar riorganizim institucional, duke u zëvendësuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike AKSK.

Më konkretisht në marrëveshje citohen bazat ligjore të mëposhtme:

- Ligji nr. 2/2017 "*Për Sigurinë Kibernetike*", i cituar në marrëveshje, është shfuqizuar nga Ligji nr. 25/2024 "*Për Sigurinë Kibernetike*", hyrë në fuqi më 03.05.2024;
- Vendimi nr. 141, datë 22.2.2017 "*Për organizimin dhe funksionimin e AKCESK*" është shfuqizuar shprehimisht nga VKM nr. 783, datë 18.12.2024 "*Për organizimin dhe funksionimin e AKSK*";
- Vetë institucioni AKCESK, palë nënshkruese e marrëveshjes, nuk ekziston më si entitet i veçantë, funksionet e tij janë kaluar te AKSK;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" është shfuqizuar nga Ligji nr. 124/2024, hyrë në fuqi në shkurt 2025;
- VKM nr. 1084, datë 24.12.2020 "*Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025*", ka përfunduar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur komente mbi rekomandimet e përcjella me Projektaportin me shkresën nr. 622/2 Prot, datë 28.07.2026.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës nuk ka në strukturën e saj një punonjës të dedikuar për kryerjen e detyrave që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Gjithashtu, institucioni nuk disponon asnjë akt administrativ si, urdhër, vendim apo shkresë, nëpërmjet të cilit të jetë caktuar struktura apo specialisti përgjegjës për ushtrimin e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të cilat në përputhje me nenin 25 pika "b" të Ligjit nr.43/2023 "*Për qeverisjen elektronike"*, i ndryshuar ku përcaktohet se AKSHI është ofruesi i shërbimeve të përqendruara TIK.
Kjo situatë përbën një dobësi organizative, e cila rrit rrezikun e mos administrimit në mënyrë efektive të funksioneve të TIK-ut dhe të moszbatimit të vazhdueshëm të masave për administrimin dhe sigurinë e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim me parimet e kontrollit të brendshëm dhe praktikat më të mira të menaxhimit të sigurisë së informacionit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
1.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrin masa për të kërkuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit caktimin me akt administrativ, të një strukture ose specialisti përgjegjës për ushtrimin, administrimin dhe koordinimin e funksioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Nëpunësi për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk ka ndjekur trajnime për përditësimin dhe kualifikimin e njohurive profesionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave. Gjithashtu, punonjësit e institucionit nuk kanë zhvilluar trajnime në këtë fushë, duke ndikuar drejtpërdrejt në nivelin e njohurive dhe ndërgjegjësimit të personelit për zbatimin e kërkesave ligjore si edhe në cilësinë e masave për mbrojtjen e të dhënave të fëmijëve, që përbën fushën kryesore të veprimtarisë së institucionit. Kjo situatë është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 124/2024 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale".*
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
2.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të marrë masa për zhvillimin e trajnimeve dhe përditësimin e vazhdueshëm profesional të Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të organizojë trajnime dhe aktivitete ndërgjegjësuese për punonjësit, me qëllim rritjen e njohurive dhe garantimin e zbatimit të kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka emëruar Nëpunësin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale por nuk ka publikuar në faqen zyrtare femijet.gov.al dhe faqen e kontaktit asnjë informacion identifikues mbi NMDP-n si emri, emaili, apo funksioni, në kundërshtim me nenin 34/3 të Ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", ku kërkohet shprehimisht publikimi i të dhënave të kontaktit të NMDP-s si detyrim i pavarur nga emaili institucional i përgjithshëm.
Nga auditimi i strukturës së menu-së së faqes zyrtare të ASHDMF-së në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar, u konstatuan këto mangësi:
- Moduli "*Marrëveshje*" është publikuar dy herë, përkatësisht te seksioni "*Legjislacioni*" dhe te seksioni "*Bashkëpunim*", duke krijuar dublikim të padobishëm të informacionit dhe duke vështirësuar lundrimin e përdoruesit;

- Seksioni "*Statistika për fëmijët*", që duhet të ofrojë të dhëna statistikore mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, nuk është i aksesueshëm, duke privuar publikun nga informacion që duhet të jetë i disponueshëm sipas detyrimeve të transparencës;
- Te moduli i Transparencës, opsioni "*Programi i Transparencës*" është publikuar dy herë, gjë që ndikon negativisht në qartësinë dhe strukturën e menu-së;
- Disa linqe të cilat shfaqin mesazhin '404: Page Not Found', duke pamundësuar aksesimin e informacionit përkatës;
- Konstatohet se ka linqe që të drejtojnë në video që nuk janë më të disponueshme, pasi shfaqet mesazhi "Video ID … has been deleted!", duke pamundësuar aksesimin e përmbajtjes;
- Gjatë verifikimit u konstatua se një nga linqet e publikuara në faqen zyrtare të ASHDMF-së ridrejton në faqen e Këshillit të Evropës (Council of Europe) ku dokumenti nuk është publik, dhe për të cilin kërkohet identifikim, çfarë nuk lejon aksesimin e informacionit nga publiku;
- Një pjesë e dokumenteve të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, përfshirë te programi i transparencës, por jo vetëm, shkarkohen automatikisht në pajisjen e përdoruesit, pa kërkuar konfirmim paraprak, çka përbën praktikë jo standarde dhe potencialisht problematike nga pikëpamja e sigurisë së informacionit.

Gjithashtu, në faqen zyrtare të ASHDMF-së mungon informacioni mbi datën e publikimit dhe datën e përditësimit të fundit të përmbajtjes, duke kufizuar transparencën dhe mundësinë e verifikimit të aktualitetit të informacionit. Kjo në kundërshtim me pikën 1 "dh" të Vendimit nr.782, datë 18.12.2024 *"Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të Autoriteteve Publike".*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 8-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, të marrë masa për përditësimin dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare, duke siguruar publikimin e të dhënave të kontaktit të Nëpunësit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, funksionalitetin e plotë të seksioneve dhe linqeve, si dhe përputhshmërinë e faqes zyrtare me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i marrëveshjes së bashkëpunimit, protokolluar në ASHDMF me nr. 16/2 prot. dhe pranë AKCESK me nr. 86 prot., datë 06.02.2024, u konstatua se e gjithë baza ligjore e përcaktuar në nenin 3 të saj është shfuqizuar ose ka përfunduar efektet pas datës së nënshkrimit. Konkretisht:

- Ligji nr. 2/2017 "*Për Sigurinë Kibernetike*", shfuqizuar nga Ligji nr. 25/2024, hyrë në fuqi 03.05.2024;
- VKM nr. 141, datë 22.02.2017 "*Për organizimin dhe funksionimin e AKCESK*" Shfuqizuar nga VKM nr.783, datë 18.12.2024;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", shfuqizuar nga Ligji nr. 124/2024, hyrë në fuqi shkurt 2025;
- VKM nr. 1084, datë 24.12.2020 "*Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020–2025*" përfunduar dhe zëvendësuar nga Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030.

Njëkohësisht, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike – AKCESK që është njëra nga palët nënshkruese, ka pësuar riorganizim institucional dhe funksionet i kanë kaluar Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.

Mbështetja e marrëveshjes së bashkëpunimit në një bazë ligjore të shfuqizuar ose me efekte të përfunduara, krijon pasiguri juridike në zbatimin e saj, rrezikon paqartësi në përcaktimin e roleve, përgjegjësive dhe mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe mund të ndikojë negativisht në sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, të rishikojë marrëveshjen ekzistuese të bashkëpunimit dhe të nisë procedurat për lidhjen e një

marrëveshjeje të re bashkëpunimi me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, si institucioni pasardhës i Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, duke identifikuar saktë palët nënshkruese sipas organizimit institucional aktual. Gjithashtu, Agjencia të vendosë një procedurë të brendshme për monitorimin periodik të vlefshmërisë së marrëveshjeve dhe memorandumeve në fuqi, si dhe të parashikojë në marrëveshjen e re një klauzolë rishikimi, e cila detyron palët ta përditësojnë atë në rast ndryshimesh ligjore ose riorganizimi institucional të njërës prej palëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se deklaratat e konfidencialitetit të nënshkruara nga punonjësit e ASHDMF-së nuk janë rinovuar në përputhje me Aneksin 1 të Rregullores "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", miratuar me urdhrin nr. 13, datë 04.05.2026. Deklaratat ekzistuese të nënshkruara faktikisht nga punonjësit citojnë si bazë ligjore Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i cili është shfuqizuar, ndërkohë që Aneksi 1 i rregullores aktuale përcakton si bazë ligjore Ligjin nr. 124/2024. E njëjta referencë e shfuqizuar gjendet edhe në deklaratën e publikuar në faqen zyrtare të internetit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
5.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, të marrë masat që të gjithë punonjësit e strukturës të nënshkruajnë deklaratë të re konfidencialiteti sipas formatit të miratuar në Aneksin 1 të Rregullores "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", duke i arkivuar ato në dosjet përkatëse të personelit. Njëkohësisht, të hiqet nga faqja zyrtare e internetit deklarata që referon Ligjin nr. 9887/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* dhe të zëvendësohet me formatin e përditësuar. Të përcaktohet një strukturë përgjegjëse për verifikimin periodik të përputhshmërisë së dokumentacionit të brendshëm me kuadrin ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, në cilësinë e kontrolluesit, ushtron koordinim funksional mbi punonjësit socialë të njësive për mbrojtjen e fëmijës pranë bashkive, të cilët aksesojnë dhe përpunojnë të dhëna personale të kategorive të veçanta të rasteve të mbrojtjes së fëmijës. Deklarata e konfidencialitetit që nënshkruhet prej tyre është formulari i parashikuar si Aneksi 11 i VKM nr. 578, datë 3.10.2018, ndërsa ndarja e informacionit realizohet nëpërmjet formularit "Miratimi për ndarjen e informacionit" të së njëjtës VKM. Njëkohësisht, ASHDMF nuk ka hartuar një instrument të vetin, në formën e një deklarate të veçantë konfidencialiteti të nënshkruar drejtpërdrejt nga punonjësit socialë që përpunojnë të dhëna nën autoritetin e saj. Mungesa e saj krijon dobësi në garantimin e përgjegjshmërisë së punonjësve socialë për ruajtjen e konfidencialitetit, duke rritur rrezikun e cenimit të sigurisë dhe privatësisë së të dhënave personale të fëmijëve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
6.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, brenda kompetencave të saj, të hartojë dhe miratojë me urdhër të titullarit një deklaratë të veçantë konfidencialiteti, e cila të nënshkruhet drejtpërdrejt nga punonjësit socialë të njësive për mbrojtjen e fëmijës që përpunojnë të dhëna nën autoritetin e saj, si dhe të hartojë udhëzime të shkruara për përpunimin e këtyre të dhënave.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pajisjeve informatike rezultoi se nga 9 kompjuterët në funksion të punonjësve të strukturës, me sisteme operimi si në vijim;
- 3 kompjuterë përdorin Windows 11, version aktual, i mbështetur nga prodhuesi;

- 3 kompjuterë përdorin Windows 10, për të cilin mbështetja standarde nga Microsoft ka përfunduar më 14 tetor 2025;
- 3 kompjuterë përdorin Windows 7, për të cilin përditësimet e sigurisë kanë përfunduar prej kohësh.

Bazuar në sa më sipër, 6 nga 9 pajisjet, operojnë me sisteme që nuk përfitojnë përditësime sigurie nga prodhuesi. Kjo situatë është në kundërshtim me nenin 22 të Ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i cili parashikon se kontrolluesi zbaton masa të duhura teknike dhe organizative dhe duhet të jetë në gjendje të provojë zbatimin e tyre, si dhe me nenin 5 të Rregullores së ASHDMF-së "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", i cili kërkon garantimin e integritetit dhe konfidencialitetit të të dhënave personale, kërkesë që nuk mund të konsiderohet e përmbushur kur infrastruktura teknike përfshin sisteme operimi që nuk përfitojnë më përditësime sigurie nga prodhuesi.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, të hartojë dhe zbatojë një plan konkret veprimi, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare te Shoqërisë së Informacionit si institucion përgjegjës për infrastrukturën qendrore të teknologjisë së informacionit, për heqjen nga përdorimi ose përditësimin e menjëhershëm të 6 pajisjeve me sisteme operimi që nuk mbështeten më nga prodhuesi. Njëkohësisht, të mbahet një inventar i përditësuar i pajisjeve informatike me evidentimin e versioneve të sistemeve të operimit dhe të datave të përfundimit të mbështetjes.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Rregullorja "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", miratuar me Urdhër të Drejtorit nr. 13, protokolluar me nr. 99 prot., datë 04.05.2026, parashikon një sërë masash teknike sigurie që i ngarkohen drejtpërdrejt ASHDMF-së, si: administrimin e aksesit të bazuar në rol dhe kredenciale individuale, garantimin e kanaleve të sigurta për dërgimin dhe marrjen e të dhënave, mbrojtjen e pajisjeve zyrtare me fjalëkalim dhe politika aksesi, ndalimin e nxjerrjes së të dhënave në pajisje të jashtme dhe bllokimin e menjëhershëm të aksesit të punonjësve të larguar nga detyra. Këto detyrime nuk mund të zbatohen nga institucioni në mënyrë të pavarur, pasi:

a. ASHDMF nuk disponon sisteme informatike të dedikuara dhe menaxhimi i informacionit realizohet kryesisht nëpërmjet shkresave zyrtare dhe postës elektronike zyrtare;
b. administrimi i infrastrukturës qendrore TIK, i postës elektronike, i sistemeve të vazhdimësisë dhe rikuperimit nga fatkeqësia, si dhe përcaktimi i standardeve të sigurisë TIK, janë kompetencë ekskluzive e AKSHI-t.

Mospërputhja ndërmjet detyrimeve të parashikuara në rregullore dhe mundësive reale të zbatimit të tyre, sjell paqartësi në ndarjen e përgjegjësive midis ASHDMF-së si kontrollues dhe AKSHI-t si administrator i infrastrukturës. Kjo krijon rrezikun që masa të caktuara sigurie të mos zbatohen nga asnjëra palë, si dhe e vendos institucionin në pamundësi objektive për të provuar zbatimin e masave teknike që ka marrë përsipër me akt të brendshëm.

Konstatimet e mësipërme bazohen në nenin 22 të Ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", sipas të cilit kontrolluesi zbaton masa të duhura teknike dhe organizative dhe duhet të jetë në gjendje të provojë zbatimin e tyre, si dhe nenet 9, 24, 25, 26, 27, 41 dhe 42 të Ligjit nr. 43/2023 "*Për qeverisjen elektronike*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës të rishikojë Rregulloren "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", duke ndarë qartë përgjegjësitë. Masat që varen nga vetë institucioni si rregulla të brendshme, autorizimet e aksesit, udhëzimet për punonjësit, klasifikimi i informacionit, të mbeten përgjegjësi e agjencisë, ndërsa masat teknike që administrohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, të trajtohen si shërbime që merren prej tij. Njëkohësisht, Agjencia

Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës t'i kërkojë zyrtarisht Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit konfirmim me shkrim për masat teknike të sigurisë që zbatohen për infrastrukturën dhe postën elektronike të institucionit, dhe të shqyrtojë mundësinë e nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi që përcakton qartë detyrat e secilës palë, në përmbushje të kërkesave ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi Rregulloren "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", miratuar me urdhrin nr. 13 prot., datë 04.05.2026, protokolluar me nr. 99 prot., datë 04.05.2026, u konstatua se, megjithëse në Aneksin 6 është përcaktuar formati i regjistrit të veprimtarive të përpunimit që duhet plotësuar nga çdo drejtori/sektor, plotësimi i të dhënave lidhur me përpunimin nuk ka filluar. Vetë rregullorja parashikon shprehimisht se çdo proces përpunimi duhet të pasqyrohet në regjistrin e veprimtarive të përpunimit. Në mungesë të tij, institucioni nuk disponon pasqyrë të plotë të kategorive të të dhënave që përpunon, të qëllimeve, bazave ligjore, marrësve dhe afateve të ruajtjes, çka pengon zbatimin e parimeve të minimizimit dhe kufizimit të afatit të ruajtjes dhe e bën të pamundur provimin e përputhshmërisë përpara autoritetit mbikëqyrës, në kundërshtim me nenin 22 të Ligjit nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
9.1 Rekomandimi: Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, nëpërmjet Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të hartojë dhe plotësojë regjistrin e veprimtarive të përpunimit sipas kategorive të të dhënave që përpunon dhe formatit të përcaktuar me urdhër të titullarit, për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale dhe rishikohet e përditësohet një herë në vit apo sa herë ndryshojnë veprimtaritë e përpunimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT